



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM

Nr. 295, datë 06.07.2021

PËR

**DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.257, DATË 17.06.2021, TË KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR, “PËR TRANSFERIMIN E PËRKOSHËM ME
PËLQIM TË GJYQTARIT Z. {...}”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61 dhe në shkronjën “c”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 9, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkoshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesën për sqarim vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, dërguar me postë elektronike më datë 02.07.2021 dhe protokolluar me aktin 2892/3, datë 02.07.2021, si dhe informacion shtesë, dërguar me postë elektronike më datë 05.07.2021 dhe protokolluar me aktin nr. 2892/4, datë 05.07.2021, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të Vendimit nr.257, datë 17.06.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për transferimin e përkoshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}”, shtohen pikat 3/1, 3/2 dhe 3/3 me këtë përmbajtje:

“3/1. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të vendimit sipas pikës 2, gjyqtari {...} dorëzon të gjitha çështjet gjyqësore që i janë ngarkuar për të gjykuar si gjyqtar i vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, për të cilat nuk ka filluar hetimi gjyqësor.

3/2. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që i janë ngarkuar për të gjykuar si gjyqtar i vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, për të cilat ka filluar hetimi gjyqësor.

3/3. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që i janë ngarkuar për të gjykuar si kryetar ose anëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR